

KLARA KODRA**PASQYRIMI I LETËRSISË ARBËRESHE
NË “STUDIME FILOLOGJIKE”**

50 vjet shënojnë pjekurinë në jetën e një njeriu.

Në jetën e një organi të shtypit shkencor një periudhë gjysmëshekullore dëshmon për një grumbullim përvoje, po edhe për një rini relative që përmban ende shumë potencial krijues.

Revistat shkencore pasqyrojnë periudha të caktuara historike dhe një ideologji të caktuar, po edhe nivele të caktuara zhvillimi të shkencave dhe arteve ose, në veçanti, të një shkence ose arti të caktuar.

Kur nisi jetën e vet revista “Studime filologjike” (një vazhduese e nivelit më të lartë të Buletinit të Shkencave Shoqërore të Universitetit), shkenca letrare shqiptare ishte në adoleshencë. Revista u rrit dhe u poq bashkë me shkencën, zëdhënëse e së cilës ishte.

Kjo revistë lindi në një periudhë të caktuar historike, atë të të ashtuquajturit socializëm i cili rrok tridhjetë vjet të jetës së saj, po rroku edhe periudhën pas viteve 90-të, periudhën bashkëkohore të shkrirjes së akujve ideologjikë.

Kjo revistë qe njëkohësisht një tribunë letrare dhe gjuhësore. Ajo i dha një vend të veçantë një dege të rëndësishme të letërsisë shqiptare që u zhvillua në diasporë nga një pjesë e kombit e transplantuar në tokë të huaj që ruajti limfën e zakoneve dhe këngëve popullore. Kjo pjesë e kombit do t’i ngrinte ato në nivelin e një letërsie që u zhvillua paralelisht me letërsinë e shfaqur në atdheun e të parëve.

Revista “Studime filologjike” luajti rolin e zbulueses dhe të vlerësueses së kësaj letërsie, duke ia bërë të njohur shqiptarëve të tokës mëmë dhe duke u munduar t’ia gjejë vendin asaj në hartën e tërë letërsisë shqiptare.

Ajo e realizoi këtë mision në formën e artikujve, studimeve dhe recensioneve, si edhe nëpërmjet botimit të materialeve letrare të panjohura.

Kështu në faqet e kësaj reviste, për një periudhë prej gjysmë shekulli ndeshim vlerësime në rrafshin e mesazhit dhe të formës të autorëve të veçantë arbëreshë, qofshin ata të shquar, mesatarë dhe minorë, vlerësime ato që jepen për herë të parë dhe rivlerësime, paraqitje për herë të parë të autorëve të panjohur për publikun shqiptar, paraqitjen e tezave të reja shkencore lidhur me letërsinë arbëreshe, përpjekje për të zgjidhur çështje nevralgjike të përgjithshme të kësaj letërsie apo të krijimtarisë së autorëve të veçantë.

Në faqet e revistës “Studime filologjike” vëmë re, në marrëdhënie me letërsinë e arbëreshëve të Italisë, një *larmi* studiuësish të vjetër e të rinj, një *larmi* autorësh arbëreshë të studiuar dhe të vlerësuar nga të cilët disa krijues të mëdhenj, mesatarë dhe minorë; në periudhën e dytë historike të përjetuar nga kjo revistë që vazhdon edhe tani, u kapërcye uniteti fiktiv i metodës së vetme të pranuar për studim, metodës sociologjike marksiste, dhe u vu re gjithashtu një *larmi* metodash studimi, ndër të cilat metodat formaliste dhe strukturaliste dhe metoda komparativiste.

Artikujt dhe studimet e botuara të “Studime filologjike” patën meritën të formojnë një bazë për kapitujt e letërsisë arbëreshe që bëjnë pjesë në “Historinë e letërsisë shqiptare” të botuar më 1983, të cilëve, megjithë ideologjizimin e pashmangshëm për kohën nuk u mungojnë vlerat me të vërtetë shkencore, ndër të parat e të cilëve historizmi, po edhe disa analiza të formës.

Artikujt dhe studimet që panë dritë të “Studime filologjike” jo rrallë qenë bërthama monografish shkencore mbi letërsinë arbëreshe.

Pasqyrimi i letërsisë arbëreshe në këtë revistë evoluoi nëpërmjet debateve shkencore, po edhe përmes një lufte midis ideologjizimit dhe objektivitetit shkencor.

Ideologjizimi u shfaq në parësinë që iu dha mesazhit në raport me formën dhe në vështrimin e mjaft autorëve përmes optikës klasore si edhe në mungesën e pasqyrimin të ndonjë autori që u quajt reaksionar si Zef Skiroi ose në lënien mënjane për një kohë të gjatë të letërsisë bashkëkohore arbëreshe.

Madje edhe një autor madhështia e të cilit iu imponua shkencës letrare të kohës si De Rada nuk u pasqyrua në përpjesëtimet e duhura në rastin e 150-vjetorit të lindjes.

Patë edhe recensione ku karakteri ideologjizues e dëmtoi në fakt objektivitetin shkencor siç qenë recensione që iu bë “Historisë së letërsisë shqipe” botuar më 1959 të Zef Skiroit të Ri dhe recensione që iu bënë dy veprave të studiuësit Gradilone “Sprova mbi letërsinë shqipe” (1960) dhe “Sprova të reja mbi letërsinë shqipe” (1974).

Mund të ndalemi veçanërisht në këto të fundit. Një ideologjizim i skajshëm u vu re në recensionin e Filip Ndocajt në “Studime Filologjike”, 1968/2 për veprën e parë që nga citojmë: “*Mbi gjithë pretendimet për të sjellë ndonjë gjë të re e me vlerë në fushën e studimeve të historisë shqipe, në thelb, vepra është nën nivelin e kërkesave më elementare të shkencës*”. (Nënvizimi ynë).

Përveç zbatimit të metodës formaliste krahasuese e cila e shkëput letërsinë nga jeta e popullit, nga trualli që përcakton zhvillimin e saj dhe e kthen studimin e vërtetë shkencor në gjetjen e analogjive thjesht letrare, formale, një e metë tjetër e rëndë, e kësaj vepre është se autori shumicën e

studimeve ua ka nënshtruar qëllimeve të caktuara politike. Librin e Gradilones e përshkon një koncept i gabuar, kryekëput i shtrembër mbi historinë e letërsisë shqipe, mbi rrethanat e faktorët që kanë përcaktuar zhvillimin e saj. Autori bën çmos për të mohuar karakterin origjinal të letërsisë shqipe, duke e nxjerrë atë të varur nga letërsia latine dhe italiane” (Shih “Studime filologjike, 1968/2, f. 185).

Më objektiv, ndonëse i ideologjizuar është recensionin për veprën tjetër të Gradilones nga Koço Bihiku, botuar më 1981. Këtu ndeshim një polemikë lidhur me realizmin e Santorit. Nga një anë Bihiku ka një koncept më të qartë për realizmin se studiuesi arbëresh, sipas të cilit “personazhet e veprës letrare ... mendojnë ... sillen dhe ... veprojnë në përputhje me logjikën e brendshme të tyre që është përcaktuar nga karakteri shoqëror që mishërojnë, ndërsa Gradilone e sheh realizmin të përshkrimi i jetës së njerëzve të thjeshtë, po megjithatë, Bihiku arrin në një konkluzion, sipas nesh, të gabuar për t’ia mohuar krejt realizmin këtij shkrimtari arbëresh dhe për ta quajtur natyralist, duke mbivlerësuar thelbin fetar dhe konservatorizmin e pikëpamjeve politike të tij dhe duke mos parë çastet e revoltës ose të miratimit të dhunës individuale dhe shoqërore si edhe disa karaktere që arrijnë ta mishërojnë thelbin e vet shoqëror.

Bihiku flet për “një prirje subjektiviste dhe nga pozita shkencore jo parimore në shqyrtimin e fakteve letrare të Gradilones, duke u bazuar thjesht te ndërthurja e formalizmit me komparativizmin në veprën e tij. Megjithatë vlerëson disa vëzhgime interesante në këtë vepër.

Natyrisht të gjitha këto vepra, krahas meritave në të cilat shquhet më tepër Gradilone, kishin edhe shfaqje subjektivizmi dhe kufizime, po ato u panë në optikën e metodës sociologjike (të pretenduar si marksiste) për t’u nxjerrë pa të drejtë si vepra të përcaktuara dhe shtrembëruese të materialit letrar të analizuar prej tyre.

Artikujt dhe studimet e botuara të “Studime filologjike” për letërsinë arbëreshe patën kryesisht karakter historiko-letrar, po pati raste që trajtuan çështje të teorisë së letërsisë ose elemente të kritikës dhe të kritikës së kritikës.

Në periudhën pas viteve 90-të kjo revistë mori një karakter mbarëshqiptar, duke u dhënë vendin e duhur studiuesve arbëreshë dhe kosovarë.

Brezi i vjetër i studiuesve shqiptarë luajti kryesisht një rol prej pionieri në “çarjen e tokave të virgjëra” të letërsisë arbëreshe. Mund të përmendim emra si Ziaudin Kodra, Dhimitër Shuteriqi, Mahir Domi dhe Aleksandër Xhuvani.

Në mënyrë të veçantë u shquan Ziaudin Kodra dhe Dhimitër Shuteriqi në zbulimin e materialeve të reja të panjohura të shkrimtarëve minorë

arbëreshë dhe në ndriçimin e figurave të mëdha si themeluesi i kësaj letërsie dhe bashkëthemeluesi i letërsisë artistike shqiptare, Jeronim de Rada.

Ziaudin Kodra vizatoi një portret të goditur të këtij shkrimtari të shquar, duke evidencuar meritat e tij historike, patriotike dhe estetike dhe duke i dhënë një shpjegim origjinal fragmentarizmit të “Skanderbekut të pafan”, duke e lidhur atë me vazhdimësinë pesëshekullore dhe karakterin tërësor të luftës së shqiptarëve kundër pushtuesve, çka, sipas tij, përlligj mosrespektimin e tri uniteteve në poemë nga ana e De Radës.

Studiuesi i lartpërmendur mund të quhet si zbulues i dy poetëve minorë, po që sjellin një notë të veçantë si Stratigoi dhe Françesk Krispi Glaviano. Për të parin Z. Kodra boton edhe materiale konkrete, poezi të panjohura; për të dytin, duke dhënë një vlerësim kritik të botimit të poezive të këtij autori nga studiuesi arbëresh Mateo Shambra hedh dritë edhe mbi figurën e poetit.

Studiuesi u kushton vëmendje edhe poemës “Kënkat e Krujës” si Kozmo Serembes, një lloj i veçantë i poemës epike.

Dhimitër Shuteriqi pati meritën të zbulonte i pari variantet e hershme të “Milosaos” dhe të “Serafinës”, duke ndriçuar kështu gjenezën krijuese të këtyre veprave dhe të pasuronte jetëshkrimin e një poeti aq origjinal si Serembeja duke botuar letra të pazbuluara të tij. Ai u ndal edhe në jetëshkrimin dhe veprën e poetit të parë të letërsisë së vjetër arbëreshe, Matrëngës.

A. Xhuvani vizaton profilet e dy shkrimtarëve të shquar të letërsisë arbëreshe, Zef Serembe dhe Gavril Dara i Ri.

Studiuesi Muzafer Xhaxhiu ndalet në një vepër të lënë pas dore nga studiuesit letrarë arbëreshë dhe shqiptarë si “Rrëfime të Arbërit” dhe zbulon vlera të paevidencuara të saj.

Koço Bihiku në artikullin “Rrymat ideore dhe artistike dhe gjinitë e letërsisë shqipe” (Studime filologjike, 1967/1) i njeh meritën letërsisë arbëreshe nëpërmjet autorit të saj të madh De Radës të ngritjes së nivelit estetik të letërsisë shqiptare në një rang të denjë në krahasim me letërsinë simotra të Ballkanit dhe të afrimit me letërsinë europiane të kohës.

Ai i radhit emrat e De Radës dhe të Serembes në mes të shkrimtarëve të shquar të letërsisë shqiptare. Ai vlerëson gjithashtu pasurimin që i bën letërsisë shqiptare në gjini e lloje autorët arbëreshë duke zhvilluar poemën romantike dhe një lloj të vështirë dhe elitare si sonetin.

Në fakt, në faqet e revistës “Studime filologjike” në këto pesëdhjetë vjet lanë gjurmët e tyre në studimin e letërsisë arbëreshe tre breza shkencëtarësh, brezi i paraluftës që e përmendëm më lart, brezi pasluftës ku spikasin në veçanti emrat e Jorgo Bulos dhe Ali Xhikut, po mund të përmendet edhe ndonjë emër tjetër si Thanas Gjika dhe, së dyti, brezi i studiuesve të rritur

në vitet nëntëdhjetë e tutje që zbatuan kryesisht metodat moderne, ku mund të evidencojmë studiueset e talentuara Blerina Suta dhe Merita Sauku Bruci.

Edhe ne kemi dhënë ndihmesën tonë, duke u ndalur në veprat më të spikatura të letërsisë arbëreshe dhe duke u munduar të zgjidhim çështje të mbetura pezull apo të ndalemi në aspekte të panjohura të këtyre veprave.

Disa nga përfaqësuesit e dy brezave të parë patën mundësinë të japin ndihmesën e vet në dy periudha dhe, si rrjedhim, të evoluojnë duke ruajtur metodën sociologjike ose duke e ndërthurur me elemente metodash të tjera si Jorgo Bullo dhe Ali Xhiku.

Pas viteve 90-të revista “Studime filologjike” u gjallërua me gjak të ri përmes shkrimeve të tre studiuesve arbëreshë të ndryshëm në moshë, po secili i pajisur me dhunti të veçanta, Italo K. Fortino, Françesk Altimari dhe Mateo Mandalà.

Këta studiues shfrytëzuan arritjet e filologjisë për vështrime të reja dhe më të thella mbi autorë të ndryshëm arbëreshë, mbi gjenezën e veprës së tyre apo ndriçimin e ndonjë aspekti a elementi të veçantë të tyre.

Për herë të parë në sajë të ndihmesës së studiuesit Fortino në faqet e revistës “Studime filologjike” u shfaq një panoramë e letërsisë arbëreshe bashkëkohore me ngjyrat e individualiteteve të ndryshme krijuese që pikëzohen në të.

Një rubrikë e veçantë e revistës u është kushtuar gjithnjë diskutimeve. Gjithnjë e më tepër aty kanë zënë vend hipoteza dhe debate që përplasen ngjashëm me retë që prej tyre të burojnë shkrepitja e së vërtetës.

“Studime filologjike” u ka dhënë vend çështjeve ku ndërthuren historia e letërsisë dhe teoria letrare. Kështu studiuesi Ali Xhiku ka hedhur tezën për një shkollë romantike arbëreshe, studiuesi Jorgo Bullo ka hedhur mendime origjinale për tipologjinë e poemës arbëreshe duke mos pranuar si poemë “Gjellën e Shën Mërisë” së Varibobës që e quan cikël poezish lirike dhe duke nënvizuar afërsinë e poemave të De Radës më tepër me romanin se sa me epin.

Gjejmë në revistë edhe elementë të kritikës së shkencës letrare ku studiuesit vlerësojnë njeri-tjetrin: Mahir Domi analizon Aleksandër Xhuvanin, Jorgo Bullo vlerëson monografinë e Mandalasë për Skiroin, Fortino jep mendime për Camajn dhe për Gradilonen.

Duhet thënë se revista “Studime filologjike” në këtë pesëdhjetëvjetor të saj ndodhet në vijë ngjitjeje. Në rast se metoda sociologjike u kishte dhënë studimeve të letërsisë arbëreshe tiparin e historizmit që i mbronte deri diku nga skajshmëritë subjektive; metodat strukturaliste, formaliste dhe komparativiste i kanë pasuruar ato studime në *thellësi* duke gërmuar në minierën e pasur të formës së autorëve më të shquar; në *gjerësi*, duke lidhur veprën e këtyre autorëve me letërsinë italiane dhe europiane. Në studimin e këtyre lidhjeve të

fundit kanë dhënë ndihmesë studiuesit e dy brezave: Italo Fortino dhe Blerina Suta, i pari për letërsinë e vjetër arbëreshe, e dyta për letërsinë e Rilindjes.

“Studime filologjike” ka meritën e pasqyrimin të letërsisë arbëreshe në tërë periudhat e saj: letërsinë e vjetër fetare, letërsinë e Rilindjes më pak letërsinë midis dy luftërash dhe letërsinë bashkëkohore.

Kjo revistë ka bërë objekt analize figurat e mëdha të kësaj letërsie që rrezatojnë tërë letërsinë shqiptare si De Rada, Serembe, Dara i Ri, Skiroi dhe disa autorë mesatarë dhe minorë që sjellin notën e tyre të veçantë në këtë letërsi dhe ishin të panjohur a jo plotësisht të njohur.

Revista në fjalë ka qenë qysh nga fillimi i saj një dialog midis brezash në të cilin studiuesit ia kalonin pishtarin e shkencës njeri tjetrit. Kjo vlen edhe për studiuesit e letërsisë arbëreshe në tërë hapësirën mbarëshqiptare.

“Studime filologjike” ka për të zbuluar edhe thesare të reja të letërsisë arbëreshe veçanërisht në fushën e lënë mënjanë apo të keqkuptuar të formës. Ajo do të bëhet kështu një bazë solide për monografi të ardhshme dhe mbase për historinë e re të letërsisë shqiptare.

Bibliografia kryesore (e botuar te “Studime Filologjike”)

1. Altimari, Francesco: *Mbi figurën e Skënderbeut në letërsinë gojore arbëreshe* [La figure de Scanderbeg dans la littérature orale des Albanais d'Italie], 1980/2, f. 73-81.
2. Bala, Vehbi: *Aleksandër Xhuvani për arbëreshët* [Aleksandër Xhuvani sur les Albanais de l'Italie], 1980/1, f. 129-132.
3. Bihiku, Koço: *Rrymat ideore e artistike dhe gjinitë e letërsisë shqipe që nga fundi i shek.XVIII e gjer në ditët tona*. [Les courants idéo-artistiques et les genres de littérature albanaise de la fin du XVIII^e à nos jours I 1967/1, f. 3 -11.
4. Bihiku, Koço: *Mbi disa probleme të studimit të historisë së letërsisë shqipe* [Questions d'études de l'histoire de la littérature albanist] 1968/4, f. 3-21.
5. Bihiku, Koço & Bullo, Jorgo: *Studime për letërsinë shqiptare të së kaluarës në revistën “Gjurmime Albanologjike”* [Études sur la littérature albanaise du passé publiques dans la revue “Gjurmime albanologjike”, 1983/4, f. 81-90.
6. Bihiku, Koço: *Studime për letërsinë shqiptare gjatë 40 vjetëve* [Les études littéraires albanaises pendant 40 années] 1984/4, f. 171-182.
7. Bihiku, Koço – Kodra, Klara: *Vepra poetike e Zef Serembes*, Tiranë, 1975 (L'œuvre poétique de Zef Serembe, Tirana, 1975), 1976/2, f. 227-230 (Recension).

8. Bihiku, Koço: *G. Gradilone Altri studi di letteratura albanese* (Studime të tjera për letërsinë shqiptare), Romë, 1974 [G.Gradilone, Altri studi di letteratura albanese, Roma 1974], f. 184-188 (Recension).
9. Bruci (Sauku), Merita: *Evolucioni i sistemit alfabetik të F.A.Santorit, çelës për përcaktimin e kohës së hartimit të veprave të tij*. [The evolution of F.A.Scritori s'alphabet sistem-a key to defining the timeframe of his Works], 2012/1-2, f.73-90.
10. Bulo, Jorgo: *25 vjet studime shqiptare në lëmin e historisë së letërsisë*, Studime Filologjike, 1969/4, f. 131-143.
11. Bulo, Jorgo: *Zhvillimi i shkencës letrare shqiptare (1944-1979)*, Studime Filologjike, 1979, f. 15-21.
12. Bulo, Jorgo: *Prof. E.Çabej për letërsinë shqiptare*, 1988/3, f. 125-129.
13. Bulo, Jorgo: *Një poemë arbëreshe për Skënderbenë, Shpata e Skënderbeut ndë Dibrin Poshtë*, 1968/4, f. 197-200.
14. Bulo, Jorgo & Kodra, Klara: *La diaspora e il ritorno, Mito, storia, kultura, tradizione nell'opera di Giuseppe Schirò*, Palermo 1990. (Recension), 1991/3-4, f. 211-216.
15. Domi, Mahir: *Aleksandër Xhuvani për letërsinë arbëreshe* [Aleksandër Xhuvani sur la littérature des Albanais de l'Italie], 1980/1, f. 151-153.
16. Fortino Italo Kostante: *Prirjet e letërsisë bashkëkohore arbëreshe* [Tendances de la littérature contemporaine des arbëreshes], 1989/4, f. 53-70.
17. Fortino, Italo Kostante: *Letërsia arbëreshe në shek.XVI-XVII dhe letërsia italiane* [La littérature arbëreshe des XVI^e – XVIII^e s.et la 1991/1, f. 113-124 littérature italienne].
18. Kodra, Klara: *Figura e Skënderbeut në krijimtarinë e De Radës* [La figure de Skanderbeg fans la création de De Rada], 1967/4, f. 85-95.
19. Kodra, Klara: *Mbi disa probleme të studimit të letërsisë arbëreshe në dritën e detyrave për revolucionarizimin e mëtejshëm të shkollës* [Problèmes de l'étude de la littérature arbëresh à la lumière des tâches de révolutionnarisation ultérieure de notre école] 1970/1, f. 129-135.
20. Kodra, Klara: *Zef Serembeja dhe folklori* [Zef Serembe et le folklore], 1970/2, f. 117-130.
21. Kodra, Klara: *Vlera artistike e poezisë së Zef Serembes* [La portée idéo-artistique de la poésie de Zef Serembe], 1971/1, f.29-55.
22. Kodra, Klara: *Problematika dhe veçori të formës te poema “Një pasqyrë e jetës njerëzore të De Radës”* [Problématique et particularités de la forme fans “Un miroir de la vie humaine” de De Rada], 1975/4, f. 49-65.

23. Kodra, Klara: *Pasqyrimi i epokës dhe veçori të brendisë ideore në "Skanderbekun e pafan" të De Radës* [Èpoque et particularités idéelles de Skanderbeg le malchanceux de De Rada]. 1976/3, f. 69-86.
24. Kodra, Klara: *Fillimet poetike të De Radës dhe poema "Këngët e Milosaos"* [Les débuts poétiques de jeronim De Rada et son poème "Les chants de Milosao"] 1978/2, f. 69-90.
25. Kodra, Klara: *Disa veçori të romantizmit të De Radës* [Particularités de romantisme de De Rada] 1980/2, f. 35-56.
26. Kodra, Klara: *Problematika e poemës "Kënka e sprasme e Balës" dhe disa tipare të saj* [Problématique du poème "Kënka e sprasme e Balës" et quelques particularités de sa forme], 1983/2, f. 25-50.
27. Kodra, Klara: *Poezia e F.A.Santorit* [La poésie de F.A.Santorit], 1987/2, f. 175-199.
28. Kodra, Klara: *Santori fabulist* [Santorit fabuliste], 1996/1-4, f. 19-32.
29. Kodra, Klara: *Rreth krijimtarisë poetike të Zef De Radës* [Sur la poésie lyrique de Zef De Rada], 2004/1-2, f. 19-31.
30. Kodra, Ziaudin: *Jeronim De Rada si folklorist e poet dhe ndikimi i tij tek shkrimtarët arbëreshë të shek.XIX – XX* ([Jeronim De Rada comme folkloriste et poète et son influence sur les écrivains arbëresh de s.XIX-XX des s. XIX-XX).
31. Kodra Ziaudin: *Vinçenc Stratigo (1822-1885)* [Vinçenc Stratigò 1822-1885], 1965/4, f. 71-89.
32. Kodra, Ziaudin: *Poema "Kënkat e Krujës" e Kozmo Serembes* [Le poème de Cosimo Serembe Les chants de Krujë], 1967/2, f. 93-112] (Materiale dhe dokumente).
33. Kodra, Ziaudin: *Françesso Crispi Glaviano Mbi Malin e Truntafilevet – Sul Monte delle Rose Testo e traduzione dell'Autore con Introduzione, commento e note di Matteo Sciambra, Palermo 1963, f. CXI – 78* [Francesco Crispi Glaviano, Mbi malin e Truntafilevet Sul Monte delle Rose, testo e traduzione dell'Autore con Introduzione, commento e note di Matteo Sciambra, Palermo 1963, f. CXI-78], 1965/1, f. 171-182 (Recension).
34. Mandalà, Matteo: *Jeta dhe vepra e Lekë Matrëngës* [La vie et l'oeuvre de Lekë Matrënga] 2000/1-2, f. 79-115.
35. Mandala, Matteo – *Për një interpretim të poemave dhe të poetikës së De Radës* [Pour l'interprétation des poèmes et de la poétique de De Rada] 2003/3-4, f. 15-43.
36. Mandalà, Matteo: *Vepra e pabotuar e at Gjergj Guxetës dhe fillimet e albanologjisë në shek. XVIII*. [Ouvre indit du père Gjergj Guxeta et les commencements de l'albanologie au XVIII siècle] 2006/1-2, f. 11-41.

37. Mandalà, Matteo: *Për botimin kritik të “Kënkës së sprasme të balës”, Shënime filologjike paraprake* [A propos de l'édition critique de “Kënka e sprasme e Balës (Dernière chanson de Balë) Notes philologiques préliminaires] 2006/3-4, f.5-34.
38. Mandalà Matteo: *Një vepër e pabotuar e Nikollë Filjas*. [Une oeuvre inédite de Niccolò Figlia], 2004/3-4, f. 109-150 [Materiale dhe dokumente].
39. Sinani, Shaban: *Motivi i krijimit të rruzullimit prej Pjetër Bogdanit e Nicolò Chetta-s tek Pjetër Zarishi e Atë Gjergj Fishta* [The motive for the creation of the universe; from Pjetër Bogdani and Nicolò Cheta to Pjetër Zarishi and fother Gjergj Fishta], 2013/1-2, f. 183-201.
40. Suta, Blerina: *Poetika e De Radës dhe romantizmi italian*. [La poétique de De Rada et le romantisme italien], 2003/3-4, f. 45-62.
41. Shuteriqi Dhimitër S.: *Një version i parë i “Milosaos” dhe një tjetër i “Serafinës” së De Radës*. [Remières versions de “Milosao” et de “Séraphine Thopia” de De Rada], 1974/1, f. 63-96.
42. Shuteriqi. Dhimitër S.: *Françesk Avati*, 1975/2, f. 115-127.
43. Shuteriqi, Dhimitër S.: *Nikollë Keta dhe mendimi patriotik arbëresh në prag të Rilindjes sonë* [Nicolas Chetta et la pensée patriotique des Albanais d'Italie a la ville de la Renaissance albanaise], 1975/3, f. 61-79.
44. Shuteriqi, Dhimitër S.: *Nga letërkëmbimi i Zef Serembes* [De la correspondance de Zef Serembe], 1980/4, f. 187-208 (Materiale dhe dokumente).
45. Uçi, Alfred: *Jeronim De Rada – lëvrues i estetikës teorike* [Jeronim De Rada - chercheur de l'esthétique théorique], 2003/3-4, f. 5-13.
46. Xhaxhiu, Muzafer: *Epoka dhe figura e Skënderbeut në disa nga poetët arbëreshë*. [L'époque et la figure de Skanderbeg chez quelques uns des poètes albanais d'Italie], 1967/4, f. 73-84.
47. Xhiku, Ali: *Për romanin e dyfishtë lirik të De Radës “Këngët e Milosaos”*. [A propos du double roman lyrique de De Rada le poème “Këngët e Milosaos”], 2004/3-4, f. 95-101.
48. Xhiku, Ali: Matteo Mandalà, “*Nicolò Chetta nel bicentenario*”, Palermo 2003 [Matteo Mandalà, “*Nicolo Chetta nel bicentenario*”, Palermo 2003, 2003/3-4, f. 201-204.
49. Xhuvani, Aleksandër: *Gabriel Dara i Riu*, 1980/1, f. 155-173 (Materiale dhe dokumente).
50. Xhuvani Aleksandër: *Zef Serembeja* [Zef Serembe] 1980/1, f. 175-181 (Materiale dhe dokumente).

SUMMARY

THE REFLECTION OF ARBËRESH LITERATURE IN THE MAGAZINE “PHILOLOGICAL STUDIES”

When the magazine “Philological Studies” started its life (a continuator of high level of the Bulletin of University’s Social Sciences) the Albanian literary science was struggling through its adolescence. It grew up and became mature together with the science whose spokesman it was.

This magazine came into being at a certain historical period, the one of the so-called socialism which involves 30 years of its life, but it also involves the period after the 90s, the contemporary period of ideological ices’ melting.

This magazine was also a literary and linguistic tribune. It gave a special place to an important branch of the Albanian literature which developed in Diaspora from a part of the nation, transplanted in foreign soil, which kept the sap of tradition and folksongs. This part of the nation would promote them to the level of a literature which developed parallel to the literature unveiled in the fatherland of their ancestors.

“Philological Studies” played the role of the discoverer and evaluator of this literature presenting it to the Albanians on homeland and trying to identify its place on the map of the whole Albanian literature.

It completed this mission in the form of articles, studies and recessions as well as by publication of unknown literary materials. Thus, in the pages of this magazine, for a period of half a century we are faced with assessments regarding the message and form of certain Arbëresh writers, be they renowned, middling, or minor, assessments which are given for the first time and reassessments, first time presentations of unknown authors to the Albanian public, presentation of new scientific theses dealing with Arbëresh literature, efforts to solve crucial general matters of this literature or of the activity of certain authors.

In the pages of the magazine “Philological Studies” we observe *a variety* of researches, new and old, related to the Arbëresh literature of Italy, a variety of Arbëresh authors studied and appreciated, some out of which great creators, middling and minor. In the second historical period gone through by this magazine which continues even now the fictive unity of the only accepted method of study was overcome, that is the sociological Marxist one and *a variety* of study methods was also applied, among which the formalist and structuralist as well as the comparative one.